

## PËR NJË VËMENDJE MË TE MADHE NDAJ PROBLEMEVE TE TIK –ut.

✘ **K**a kaluar më shumë se një vit nga marsi i vitit 2010 kur nisi rrugën organizimi i ri i DAR/ZA –ve, ku një ndër sektorët e rinj në këtë rrugëtim ishte dhe ai i TIK-ut (Sektori i Teknologjisë dhe i Informacionit ).

✘ **Q**ë nga ky moment herë pas here janë analizuar problemet që lidhen me këtë sektor, janë përcaktyuar detyra dhe është punuar në vazhdimësi për t'i realizuar ato. Përherë e më tepër TIK po lidhet më shumë drejtime të punës të sektorit të arsimit .Dy kanë qenë drejtimet kryesore të punës: 1.Kualifikimi i mësuesve të arsimit parauniversitar për njohjen e programeve, si MS Word ,Power Point ,Postë Elektronike etj. ; 2.rritja e efikasitetit të pajisjeve elektronike që kanë shkollat . Deri në mars 2011 janë kualifikuar rreth 800 mesues për njohjen e programeve të mësipërme .Po kështu janë bërë përpjekje për të pasur efikasitet në përdorimin e pajisjeve teknologjike duke aplikuar kualifikime specifike .Vetëm gjatë këtij viti shkollor janë formatuar rreth 300 kompjutera , ose gati 42% e të gjithë sasisë që kanë shkollat e rrethit. Sidomos në 33 laboratorët e reja të furnizuara me pc- ACER ( nga 55 laboratore gjithsej ) janë bërë instalimet e programeve të sistemit operativ Windows 7 dhe Office 2007. Po kështu është rritur shkalla e përdorimit të laboratorëve virtualë ( seti : laptop dhe videoprojektor ) në procesin mësimor –edukativ që zhvillohet në shkolla. Krahas shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të bashkisë Berat , dallojmë edhe shkollat “5 Maji “ , “Sali Gjuka “ , “M.Janina “ , Velabisht , Mbrakull , Samaticë, Mbrakull , Peshtan ,Tërpan , në integrimin e TIK-ut në procesin e mësimdhënies e nxënies.

✘ **Ë**shtë rritur shkalla e vëmendjes nga shkollat edhe për të raportuar shpejtësinë e internetit. Insistimi ynë për të bërë raportimet në kohë lidhet me faktin për të siguruar sinjal gjatë gjithë kohës, me parametra të lartë .MASH në këtë vit ka orientuar shpërndarjen e internetit në ato shkolla që në ciklin e lartë kanë më shumë se 40 nxënës . Kështu që krahas 57 shkollave që plotësojnë këtë konditë kemi kërkuar sinjal edhe për shkollat e tjera , si Malinat , Veleshnje , Skrevan, Drobonik , Mbrështan ( pra për 74 antena ). Duhet pranuar se sinjali i 17 antenave të tpit ADSL ( shkollat e bashkisë Berat e Ura vajguore ) janë më të lartë se të tjerat : Down load : 0,65 Mb/s dhe Upload : 0,20 Mb/s ; kurse sinjali i 40 antenave EAGLE dhe 17 antenave STARSAT është në nivele të ulta . Megjithë vështirësitë që burojnë nga shpejtësia e ulët e internetit , sot të gjitha shkollat kanë adresat e tyre të postës elektronike për të rritur saktësinë dhe shpejtësinë e komunikimit jo vetëm me DAR , por dhe me institucine të tjera që lidhen me arsimin ( me MASH , IZHA, AKP etj. ), veç komunikimit zyrtar shkresor.

✘ **P**roblemi i mirëmbajtjes dhe i ruajtjes të pajisjeve dhe sistemeve teknologjike lidhet pa dyshim me efikasitetin e tyre . Një pajisje e keqpërdorur nuk mund të jetë në shërbim të punës së shkollës . Ndërhyrjet e pakontrolluara të nxënësve apo mësuesve të paspecializuar në kompjutera do tye çonte në bllokime të marrjes së impakteve pozitive nga këto pajisjet që ka shkolla. Mësuesit që kanë në administrim kabinetet e kompjuterave duhet të rrisin kujdesin për mirëpërdorimin e tyre . Në rrethin tonë ka shumë shembuj të mirëmbajtjes dhe mirëpërdorimit të laboratorëve të kompjuterave , si në shkollën “B.D.Karbunara”, “1 Maji”, “22 Tetori “ , “Th.Tani”, “Mangalem “ , “K.Isak “ etj. Por gjatë këtij viti shkollor nuk munguan dhe disa vjedhje kompjuterash , si në Çiflik (dy pc) , në Qereshnik ( një pc) . Një nga arsyt ishte dhe mungesa e dyrve të hekurit , të cilat u vendosën menjehere pas ngjarjeve jo të dëshirueshme. Shkolla të rrisin bashkëpunimin me

komunitetin e pushtetin vendor për të minimizuar këto ngjarje . Më pas është detyrë e organeve të specializuara për të ndaluar keqbesit.

✘ **Për të rritur vlerën e raportit pc/nxënës , sektori TIK i DAR ka bërë studime të hollësishme ku i janë paraqitur MASH-it kërkesa për laboratorë të rinj dhe për pajisje të tjera teknologjike . Aktualisht ky tregues nuk e kalon shifrën 0.04 / nx. në rrethin tonë, shifër e cila me siguri do të rritet në të ardhmen .**

✘ **Po cilat janë disa nga prirjet e reja të integritit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në procesin mësimor ?**

® **Kohët e fundit është organizuar Drejtoria e Metodologjisë dhe e Teknologjisë në Mësimdhënie në përbërje të IZHA –s(Instituti i Zhvillimit të Arsimit ).Kjo drejtori përbëhet nga dy sektorë : ai i Metodologjisë dhe ai i Teknologjisë në Mësimdhënie. Ajo ka për mision të formulojë rekomandime për një zbatim më të mirë të metodologjive aktive dhe TIK-ut në mësimdhënie dhe mësimnxënie.Një prej funksioneve kryesore të saj është të bashkëpunojë me mësues , drejtues shkollash e me specialist te DAR/ZA në fushën e përdorimit të teknologjive në fjalë. Për më shumë informacion mund të përdorim adresën : [www.izha.edu.al](http://www.izha.edu.al) . Përdorimi i TIK-ut duhet të zerëvend që me hartimin e programeve mësimore në të gjitha lëndët e ciklet , në programet e kualifikimit , në standartet e drejtuesit , trajnerit e mësuesit sipas profileve të ndryshme ( jo vetëm profili fizikë , por edhe i ciklit të ulët , i shkencave sociale etj. ) Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie përfshin guidën për Word,Excel,Powerpoint, Internet në mësimdhënie; orë model të cilat shpjegojnë si të mësohet nëpërmjet lojës (website me lojra për të mësuar ) ; seminare të vazhdueshme për trajnimin e mësuesve në lidhje me integrimin e TIK-ut në mësimdhënie; forume interaktive në [www.izha.edu.al](http://www.izha.edu.al) dhe propozim i disa moduleve on-line ku përfshihen dhe guidat praktike. Në kontekstin e këtyre ideve , rekomandimet e Dr.Robert Mc Cloud ,ekspert i huaj qe punon pranë MASH , do të ndihmojnë në orientimin e punës në të ardhmen .**

® **Në rakordim me idet e mësipërme MASH në bashkëpunim me Microsoft , në shkurt të 2011, organizoi Forumin e Dytë të Mësuesve Inovativë . Në Konferencën e zhvilluar me këtë rast u bënë vlerësimet e duhura për TIK-un nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës ,nga Zv.Ministri i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit ,nga përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri ,nga drejtues te Microsoft-it etj. U bë prezantimi i “ Mësojini fëmijëve bazat e sigurisë “online” “ dhe prezantimi i projekteve të paraqitura nga shkollat 9-vjeçare dhe te mesme të Shqipërisë.**

**\* Disa nga rregullat që duhet t'i dinë nxënësit per t'u siguruar janë :**

- Mos t'ia tregojnë fjalëkalimin të tjerëve.
- Mos të japin asnjherë fjalëkalimin përmes një e-mail ose në përgjigje të një kërkesë me e-mail.
- Mos të shkruajnë fjalëkalime tek kompjuterat të cilët nuk i kontrollojnë prindërit, mësuesit .
- Prej informacioneve që publikohen në faqet e rrejteve sociale ,në se nuk bëhet kujdes per ruajtjen e identiteti apo te simboleve te shkolles ku je , perfitojnë predatorët e internetit , mashtruesit e internetit .

- Moshë e rekomanduar për t'u regjistruar në faqet sociale të Web-it është zakonisht 13 vjeç e më shumë .
- Nuk duhet t'kërkohet asnjëherë personalisht ndonjë person me të cilin është komunikuar vetëm online .
- Nuk duhet përdorur emri dhe mbiemri tuaj apo i miqve tuaj.
- Asnjëherë mos ndani informacione personale .
- Nëse ju përdorni kompjuter në bibliotekë ose Internet kafe , çregjistrohuni totalisht për se të largoheni.
- Raportoni çdo shenjë paralajmëuese mashtrimi të identitetit : oferta të para-aprovuara të kartës së kreditit , telefonata prej agjencive që mbledhin para ose deklarata financiare të panjohura etj.

Për më shumë informacion në këtë drejtim mund të gjendet në Internet , si për nxënësit ashtu edhe prindërit e mesuesit , për të ndihmuar në përdorimin në mënyrë të sigurt të rrjetimit social.

\* **Forumi i Mesuesve Inovatore** është një ngjarje kombëtare e arsimtarëve që konkurojnë dhe prezantojnë projektet e tyre mësimore të përpiluara me ndihmën e përdorimit të TIK-ut. Ky forum jep mundësi mesuesve që t'i shkëmbejnë projektet e tyre dhe ndërkohë të shpërblehen për punën e tyre me theks të veçantë në nivelin didaktik-inovativ me ndihmën e TIK. Projektet duhet të mbështesin pedagogjinë në bazë të kompetencave të lidhura me kriteret e të mesuarit aktiv , ku nxënësi është në qendër të të mesuarit. Në konkursin e dytë të zhvilluar në Tiranë , në 15 shkurt 2011 , u paraqitën 10 projektet më të mira të shkollave 9-vjeçare e të mesme të vendit , si : të mësojmë me dëshirë ( Vlorë ) ; arkitektura italiane në Korçë ( Korçë ) ; universi virtual ( Durrësi ) etj. Shkollave të Beratit u mbetet edhe shumë punë për t'u bërë për të prekur finalen në vitin e ardhshëm shkollor.

✎ **Projekti "Dixhitalizimi i Amzave të Arsimit Bazë "** është në vitin e dytë të zbatimit .Ai përfshin 64 shkollat 9-vjeçare.Sekretaret e shkollave , zv.drejtorët e shkollave apo mesues të trajnuar mbi bazën e njëprogrami të veçantë , për të kanë ndjekur këtë proces edhe gjatë këtij viti shkollor. Problemet e defekteve të aplikacionit i janë bërë të njohura edhe kopmanisë përkatëse DATECH që mbulon këtë projekt .Aplikacioni ka ndjeshmëri ndaj ngarkesave virusale të kompjuterave , por edhe në rastet kur personat që plotësojnë amzën dixhitale ndeshin me vështirësi, kanë mundësinë e lidhjes direkte me rrugë elektronike në adresën : [info@datech-soft.com](mailto:info@datech-soft.com) , që gjendet në manualin e amzimit me të cilin janë pajisur shkollat. Por krahas plotësimit të regjistrimit elektronik të amzave, vazhdon dhe plotësimi i amzave libër.

✎ **Objektivat e organizimit të bibliotekës dixhitale në të ardhmen janë tepër të qarta. Në kuadrin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit , funksionimi i bibliotekave në shkollat e arsimit parauniversitar do të ndihmonte në rritjen e cilësisë së mësimdhënies/nxënies.Po kështu do të rritet dhe shërbimi arsimor edhe në zonat e thella , ku aktualisht në bazë të investimeve të kohëve të fundit kemi shërbim internet.**

**Keto dhe drejtime të tjera të reja të punës do të jenë në vëmendjen e specialistëve të sek .TIK , të drejtuesve të shkollave dhe të gjithë mesuesve të rrethit të tyre , për ecurinë e teknologjisë së informacionit.**